

UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Procedura Administrative

Titulli i lëndës:	Procedura Administrative
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Gjilan
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
Detajet kontaktuese:	liridon.dalipi@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Lënda “ Procedura Administrative ” përfshinë tri fusha të veçanta <i>procedurën administrative, konfliktin administrativ dhe kundërvajtjet</i> , që përbëjnë objektin themelor të studimit të ashtuquajturës pjesës formale (procedurale) të së drejtës administrative.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës “Procedura Administrative” është që studentët marrin njohuri dhe të jenë në gjendje t’i shpjegojnë, analizojnë dhe t’i implementojnë çështjet që kanë të bëjnë me nocionet dhe institutet e së drejtës administrative procedurale.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund të modulit, pritet që studentët të marrin këto: Njohuri: -Themelore për institutet juridike dhe rregullat procedurale të cilat sigurojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e punës dhe vendosjes në administratën shtetërore dhe publike; -Të përshkruajnë dhe të analizojnë rregullat me të cilat rregullohet mënyra e ushtrimit funksioneve në administratën publike në situata individuale; -Që të jenë në gjendje të bëni interpretimin e drejtë të normës juridike-materiale dhe juridike-procedurale, në mënyrë që të bëhet vendosja e drejtë e çështjes administrative.

	Aftësi dhe Shkathtësi: - të zbatojnë mekanizmin procedural administrativ dhe gjyqësor, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike Kompetencë: -Të jenë në gjendje të aplikojnë në praktikë dispozitat juridike-materiale dhe dispozitat e ligjit mbi procedurën administrative, -Që të jenë në gjendje të bëjnë interpretimin e drejtë të normës juridike-materiale dhe juridike-procedurale, në mënyrë që të bëhet vendosja e drejtë e çështjes administrative.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në teren	2	3	6
Detyra të shtëpisë	4	2	8
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim			40
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet,etj	2.5	2	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Lënda do të mësohet përmes ligjëratave, seminareve, ushtrimeve duke mos i përjashtuar edhe forma tjera të mundshme. Ligjërata do të paraqes prezantimin e rregullave themelore hyrëse dhe studime komparative të sistemeve të së drejtës lidhur me zhvillimin e konflikteve administrative. Seminaret do të jenë një proces interaktiv i mësimi për studentët, duke u bazuar në studimin e pavarur		

	të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimeve të lëndës. Trajtimi i shembujve të ndryshëm do të ketë për qëllim lehtësimin e të kuptuarit të lëndës nga studentët. Studentëve u kërkohet që të shkruajnë së paku një punim seminarik dhe dy detyra të shtëpisë (në formë të esesë apo përpilimit të një akti administrativ) që kanë të bëjë me ndonjë prej çështjeve apo temave të trajtuara gjatë ligjëratave. Pjesa e punës së shkruar/praktike do të llogaritet në vlerësimin final të studentit.
Metodat e vlerësimit:	Duke respektuar kriteret minimale të kalueshmërisë që parasheh Rregullorja për vlerësim, gjatë semestrit do të organizohen dy teste provuese (kollokuime). Testi i parë organizohet pas përfundimit të ciklit të parë të ligjëratave dhe ushtrimeve (50% e plan programit mësimor). Testi i dytë organizohet në fund të semestrit në javën e fundit të ligjëratave të parapara. Studenti e kalon testin nëse ka fituar 50% të pikëve. Ata të cilën e kalojnë të parin mund t'i nënshtrohen testit të dytë. Provimi Provimi final organizohet për studentët të cilët nuk e kalojnë provimin me testet gjatë semestrit dhe për ata të cilët pretendojnë të marrin notë më të lartë. Testi i provimit do të jetë me shkrim; Për caktimin e notës përfundimtare do të merren parasysh edhe: 10 pikë maksimumi punimi seminarik, esetë, punimi shkencor, prezantimi. 10 pikë maksimumi pjesëmarrja në procesin mësimor – vijueshmëria dhe agazhimi gjatë ligjëratave (ushtrimeve) – aktiviteti.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Dr. Agur Sokoli, <i>E drejta procedurale administrative</i>, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2014. 2. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative në Kosovë. 3. Prof. Asoc. Dr. Fejzullah Berisha, <i>Administrata Publike dhe Kontrolli i Saj</i>. 4. Ligji për Konfliktet Administrative. 5. Ligji për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: Nr. 22 / 18 Dhjetor, 2018.Nr. 06/L -054 6. Casebook on European fair trial standards in administrative justice.
Literatura shtesë:	1. Stavileci, Esat: <i>Nocione dhe Parime të Administratës Publike</i>, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005. 2. Sadushi, Sokol: <i>E drejta administrative II</i>, Tiranë, 2008.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Kuptimi, rëndësia dhe zhvillimi i procedurës administrative;
<i>Java e dytë:</i>	Parimet themelore të procedurës administrative; Pjesëmarrësit në procedurën administrative
<i>Java e tretë:</i>	Komunikimi i organeve dhe palëve në procedurën administrative.
<i>Java e katërt:</i>	Kontrolli Administrativ dhe Raportimet e Organeve të Administratës.
<i>Java e pestë:</i>	Fillimi i procedurës (procedimit) administrative dhe kërkesat e palëve.
<i>Java e gjashtë:</i>	Të provuarit në procedurën administrative
<i>Java e shtatë:</i>	Vendimet dhe përfundimet në procedurën administrative
<i>Java e tetë:</i>	KOLLOKFIUMI
<i>Java e nëntë:</i>	Mjetet juridike në procedurën administrative
<i>Java e dhjetë:</i>	Kuptimi i ekzekutimit në procedurën administrative
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kuptimi i konfliktit administrativ në kuptimin formal dhe material
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Nocioni dhe objekti i padisë në konfliktin administrativ
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përfundimi i konfliktit administrativ
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Nocioni dhe elementet e kundërvajtjes dhe procedurës kundërvajtëse.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	KOLLOKFIUMI
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studenti sipas statutit është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Fakultetit.	